



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-5531/21
Kaçanik, 26.02.2021

Në bazë të nenit 12.2 (c) lidhur me nenin 40.2(g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4 Qershor 2008), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-5531/21 prej datës 13.02.2021, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 26 Shkurt 2021, mori këtë:

VENDIM

PËR LIRIM NGA QIRAJA KOMUNALE PËR SHFRYTËZUESIT E PRONËS KOMUNALE PËR VITIN 2021


1. Me këtë Vendim, Lirohen nga qiraja komunale shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2021, më konkretisht nga taksat e përcaktuara si në dispozitat e nenit 16 të Rregullores për Taksat Komunale 01Nr. 02-60/01-4863/20 e datës 30 Qershor 2020.
2. Lirimet nga qiraja e shfrytëzuesve të pronës komunale të përcaktuara në dispozitat e nenit 16 të Rregullores si në pikën 1. të këtij Vendimi, bëhet me qëllim të krijimit të lehtësirave të veprimtarive ekonomike dhe qytetarëve për funksionimin e tyre, për shkak të gjendjes së rënduar të tyre si rezultat i pandemisë COVID-19.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës dhe mekanizmat tjerë relevantë nga ekzekutivi i komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoritë Komunale; dhe
3. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për :	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kacanikut Kemajl Merseli, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Kacanikut	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MF-së	
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i përgjithshëm në MPL	Data: 18.03.2021 Nr.020-186/3
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Venera Çerkini Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kacanikut	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
E nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka Vendimi 01Nr.104/02-5531/21 për lirimin nga qiraja komunale për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2021, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Financave si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Financave.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Për:	Goran Rakić, Ministër në detyrë i MPL-së Irim Berisha, Sekretar i Përgjithshëm, MPL
Kopje:	Kryetari i Komunës së Kaçanikut Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL
Përmes:	Agim Krasniqi, Ministër në detyrë i Ministrisë së Financave Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave
Nga:	Bahrije Berisha, Zv. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Datë: Ministria e Financave 17.03.2021
Zyrtarët përgjegjës:	Referencë
1. Zyrtari konfirmues i	Razije Murtezaj, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave 022/2021
2. Zyrtari hartues i	Antoneta Shtufi-Gojani, Departamenti i Ndihmës Shtetërore
3. Zyrtari hartues i	
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendimi 01 Nr. 104/02-5531/21 për lirimin nga qiraja komunale për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2021

I nderuar Ministër z. Rakić,

I nderuar Sekretar i Përgjithshëm z. Berisha,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) 07/2020, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01 Nr. 104/02-5531/21 për lirimin nga qiraja komunale për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2021.

I miratuar më datë: 26.02.2021.

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 03.03.2021.

I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Financave më datë: 04.03.2021, me Nr. të Protokollit 293.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës së Kaçanikut, Ministria e Financave vlerëson se, akti i lartë cekur i komunës së Kaçanikut, nuk është në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, vetëm për pjesën që rregullon taksat komunale, me kusht që Komuna e Kaçanikut të zbatoj Rregulloren (QRK) Nr. 04/2020 për Ndihmën De Minimis.

Andaj, në lidhje me këtë, Ministria e Financave konstaton se akti i Komunës i plotëson kriteret për t'ju nënshtruar rregullave të ndihmës shtetërore, në përputhje me nenin 7 të Ligjit Nr. 05/L-100 për Ndihmën Shtetërore.

Po ashtu, vendimi i lartë cekur prek fushë veprimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, sipas Ligjit Nr. 06/L-092 për Dënimin në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Në rast të keq menaxhimit të parasë publike përgjegjësia bie mbi organizatën buxhetore në rastin konkret Komuna e Kaçanikut.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Kuvendi i Komunës së Kaçanikut
Skupština Opštine Kačanik/Municipal Assembly of Kačanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK



I	Data	06-07/20	Indi	Kaqanik
Nj. nrqj.	Nuturi	Shtojce		
01 Nr.	02-60/01-4863/20			

RREGULLORE NR. 02/2020
PËR
TAKSAT KOMUNALE

Qershor 2020

Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12, paragrafi 2, pika c), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, 04 Qershor 2008), të Kreut II dhe Kreut III të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008, 03 Qershor 2008), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016, 03 Gusht 2018), të nenit 34.5, të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Shkresës së MAPL të datës 12 Qershor 2020 - për harmonizimin e Rregullorës së Taksave Komunale të datës 28.02.2020 sipas Komenteve të MPB bashkangjitur, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur 30 Qershor 2020, aprovoj këtë:

RREGULLORE NR. 02/2020 PËR TAKSAT KOMUNALE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale në Komunën e Kaçanikut (këtu e tutje "Komuna"), lartësinë e taksave komunale, përcaktimin e kategorive të liruar nga kjo taksë dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik që nëpërmjet ndonjë aktiviteti të zhvilluar obligohen të paguajnë taksë komunale të përcaktuar me këtë Rregullore si dhe për të gjitha njësitë e Komunës që zbatojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdoruar në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

- 1.1. **Taksë komunale** - nënkupton shumën fikse dhe e pakthyeshme e pagesës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, që paguhet nga personat juridik dhe fizik autoriteteve të Komunës në mënyrën e paraparë në këtë Rregullore, në emër të:
 - 1.1.1. lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve tjera zyrtare të lëshuara nga Komuna;
 - 1.1.2. shërbimeve administrative të pranuar nga Komuna;
 - 1.1.3. ushtrimit të veprimtarisë afariste në territorin e Komunës;
 - 1.1.4. pronësisë së mjeteve motorike në territorin e Komunës;
 - 1.1.5. ndërtimit, rrënimit të objekteve dhe ndërhyrjeve në infrastrukturë komunale në territorin e Komunës; dhe

KAPITULLI VII TAKSAT KOMUNALE NDËRTIMORE DHE INFRASTRUKTURE

Neni 15

Taksa komunale për lejet për ndërtim dhe rrënim

1. Çdo person i cili synon të bëjë ndërtim apo rrënim të objekteve, paguan taksë komunale për pajisjen me leje ndërtim apo për rrënim, si në vijim:
 - 1.1. Leje ndërtimi për punët ndërtimore që maten me metër në katror (m^2) për kategorinë I - 1.20 euro për një metër në katror (1.20 €/m^2);
 - 1.2. Leje ndërtimi për punët ndërtimore që maten me metër në katror (m^2) për kategorinë II - 2 euro për një metër në katror (2 €/m^2);
 - 1.3. Leje ndërtimi për punët ndërtimore që nuk maten me metër në katror (m^2) për kategorinë I - 1.20 euro për një metër në katror (1.20 €/m^2);
 - 1.4. Leje ndërtimi për punët ndërtimore që nuk maten me metër në katror (m^2) për kategorinë II - 2 euro për një metër në katror (2 €/m^2);
 - 1.5. Leje rrënimi për punët ndërtimore që maten me metër në katror (m^2) - 0.20 euro për një metër në katror (0.20 €/m^2);
 - 1.6. Pompat e benzinës bazuar në kapacitet të rezervuareve të derivateve- 50 euro për një metër kub (50 € / m^3);
 - 1.7. Fushat e përkohëshme sportive- njëmijë e pesqind euro (1500 €);
 - 1.8. Për centralet elektrike me fuqi prodhuese të rrymës deri në 20 MW- Njëmijë euro për MW (1000 € / MW);
 - 1.9. Vendosja e antenave-transmetuesëve të ndryshëm si telefonisë celulare, fikse dhe internetit- 500 euro;
 - 1.10. Pishinat verore- 10 euro për një metër katror (10 € / m^2);
 - 1.11. Bazene për kultivimin e peshqëve- 2 euro për një metër katror (2.00 € / m^2);
 - 1.12. Ndërtimin e fabrikave për prodhimin e betonit- 10 euro për një metër kub (10 € / m^3);

Neni 16

Taksa komunale për qiranë ndërtimore dhe shfrytëzimin e tokës, pronë e komunës për biznes

1. Çdo person i cili ka marrë në shfrytëzim me qira objektet në pronësi të komunës, paguan taksë komunale si në vijim:
 - 1.1 Sipërfaqja deri në $50m^2$ - 2 euro për një metër katror (2.00 € / m^2);
 - 1.2 Sipërfaqja deri në $100m^2$ - 1.50 euro për një metër katror (1.50 € / m^2);
 - 1.3 Sipërfaqja mbi $100m^2$ - 1 euro për një metër katror (1.00 € / m^2);
 - 1.4 Sipërfaqet ndihmëse të lokaleve (kuzhinat, depot etj.)- 0.50 euro për një metër katror (0.50 € / m^2);
2. Investimi i shfrytëzuesve të përkohshëm të lokalit për përmirësimin e kushteve të punës në lokal zbritet nga ngarkesa vjetore e qirasë. Vlerësimi i kostos financiare, bëhet nga Kryetari i Komunës.
3. Qiraja për shfrytëzimin e tokës, pronë e komunës për biznes:
 - 3.1. Zona I..... 0.50 € / m^2 ;
 - 3.2. Zona II..... 0.40 € / m^2 ;
 - 3.3. Zona III..... 0.30 € / m^2 ;

3.4. Zona IV.....0.20€/m².

4. Qiraja paguhet vetëm për sipërfaqen e tokës e cila shfrytëzohet dhe në rast se shfrytëzuesit i është dashur të bëjë ndonjë ndërhyrje në objektin e tij pas urdhërave apo vendimeve të Komunës, formohet një komision i cili vlerëson investimet dhe vlera e investimeve i kompenzohet duke ju zëvendësuar në qira.

Neni 17

Taksa komunale për ndikim në infrastrukturë

1. Çdo person që ndërton një ndërtesë të re apo rehabiliton substancialisht një ndërtesë ekzistuese, me anë të cilës krijohet ndikimi të drejtpërdrejtë në infrastrukturën komunale dhe ky veprim kërkon krijimin, përmirësimin, riparimin apo zgjerimin e kësaj infrastrukture, paguan taksë komunale për ndikim në infrastrukturë.
2. Taksa komunale për ndikim të infrastrukturë përcaktohet bazuar në listën e shpenzimeve për llojet e ndryshme të infrastrukturës, si në vijim:
 - 2.1. Çmimi i instalimeve infrastrukturore sipas paramasës së projektit;
 - 2.2. Mund të eliminohet me marrëveshje (nëse aplikuesi merr përsipër shpenzimet).
3. Llogaritja e taksës komunale për ndikim në infrastrukturë bëhet në sipërfaqe bruto në metër në katror (m²) të objektit, sipas dokumentacionit teknik – projektit kryesor, për të cilin është dhënë miratimi dhe në bazë të cilit lejohet ndërtimi.
4. Pas vlerësimeve të bëra, Komuna lidh marrëveshje me shkrim me aplikuesin e lejes ndërtimore për ndërtimin e infrastrukturës.

Neni 18

Taksa komunale për rritjen e densitetit

1. Çdo person që ndërton një ndërtesë të re apo rehabiliton substancialisht një ndërtesë ekzistuese dhe kur kjo shkakton rritjen e numrit të njërive banuese në Komunë, paguan taksë komunale për rritjen e densitetit, vlerë prej 119.1 euro për kokë banori (119.1 €/kokë banori).

Neni 19

Pagesat e taksave komunale të ndërtimit, rrënim, ndikimit në infrastrukturë dhe rritjes së densitetit

1. Pagesa e taksave komunale të ndërtimit, rrënim, dhe rritjes së densitetit bëhet sipas Udhëzimit Administrativ Nr. MMPH Nr. 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushtet ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të ndërtimeve, apo çdo legjilacio pasues.
2. Pagesa e taksave komunale të ndikimit në infrastrukturë në vlerë deri në vlerë dyzet mijë euro (40.000 €) paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e aprovimit të kërkesës së lejes përkatëse dhe asnjë veprim për ndërtim dhe rrënim nuk mund të realizohen pa pagesën e kësaj takse komunale.
3. Pagesa e taksave komunale të ndërtimit, rrënim, ndikimit në infrastrukturë dhe rritjes së densitetit, shuma e të cilave tejkalojnë shumën prej dyzet mijë euro (40.000 €) mund të paguhet në tre (3) këste për një periudhë 12 mujore, duke filluar nga data e marrjes së lejes së ndërtimit, si në vijim:
 - 3.1. kësti i parë - pagesa prej dyzetë për qind (40 %) të taksës;
 - 3.2. kësti i dytë - pagesa prej tridhjetë për qind (30%) të taksës; dhe

1.2. Shtojca Nr. 2 ku janë listuar në formë tabelare të gjitha taksat qendrore të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 45

Transparenca në taksat komunale

Kuvendi Komunal përditëson Shtojcën Nr. 2 të kësaj Rregulloreje me një vendim dhe e publikon atë, kurdo që Qeveria e Republikës së Kosovës apo ndonjë agjenci e pavarur ndryshon taksat ekzistuese qendrore apo përcakton ndonjë taksë tjetër.

Neni 46

Dispozitat kalimtare

Ne rast të zbrastirës juridike nga kjo Rregulloreje me dispozita përkatëse sistimore ligjore zbatohen drejtpërsëdrejti dispozitat sistimore ligjore, që rregullojnë çështjen e përcaktimit të taksave komunale, si dhe ato akte të tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe dispozitat tjera të Udhëzimeve përkatëse administrative të ministrive.

Neni 47

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja 01/2016 për Pagesën e Tarifave, Ngarkesave Administrative, Gjobjave dhe Shërbimeve të Tjera Komunale të datës 15.02.2016

Neni 48

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare elektronike të Komunës së Kaçanikut.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

